

Vendi: Ujmirë, Klinë

Data:14.07.2024

PROCESVERBAL

Zgjedhjet e Këshillit Lokal në Ujmirë

Fillimi votimeve: ora 18:00 Përfundimi I Votimit: 21.25 min

Prezent ishin antaret e komisionit, ku prej tyre vetem përfaqesuesi i fshatrave z.Lirim Gashi ishte me vonë por pas fillimit të votimit ai është bashkangjitur komisionit punues.

Në klasen e votimit ishin prezent antaret e komisionit si dhe 3 antarë kandidat të listes së zgjedhjeve.

Vota e parë është hudhur në 18:08 min dhe ky fletëvotim ishte pa nënshkrim të z.Lirim Gashit. Situata ishte e qetë dhe shumë mirëpritese nga ana e qytetarëve dhe procesi filloi pa asnjë komplikim.

Gjatë votimit dhe procesit verehej se kishte tendenc të votimit banor që nuk ishin banor të fshatrave të bashksisë lokale të Ujmirit, në dokumentet e tyre nuk figuronte vendbanimi Çabiq, Ujmirë. Dobërdol dhe Siqevë dhe për këtë arsye nuk janë lejuar që të votojnë

Në fund të procesit ka munguar materiali apo fletëvotimet, dy antarë të komisionit janë obliguar të shkojnë në Klinë për të marrur materialin, dhe kjo dukuri shkaktoi pak vones dhe stress tek ekipi punues sepse në orët e vona filluan qytetarët të vin të votojnë. Në fakt asnjë nga antarët nuk ishim të informuar dhe as nuk ishte caktuar ora e mbylljes së votimit, dhe njëzëit vazhdonin të vinin në shkollë për të votuar.

Në diskutim me antarët e komisionit, përgjegjësi i shkolles ka mbyllur derën e shkollës dhe ka lejuar që të votojnë njëzëit që janë mbrenda shkolles duke pritur në koridor. Vendvotimi është mbyllur në ora 20.55 dhe pas 2 minutave ka filluar numrimi fletovotimeve e që pasë numrimin te votive kemi këtë rezultat :

Nënshkrime në listë: 379

Të pavlefshme-----5 vota

Sokol Krasniqi-----206 vota

Khavit Shala ----- 162 vota

Kadri Tafilaj -----5 vota

Nikolle Berisha -----1 vota

Duke u bazuar në rezultatin e zgjedhjeve pasë numrimin të votave kemi të zgjedhur Kryetarin e Keshilli, Nenkryetarin dhe anëtarët e Kryesisë si vijim:

1. Sokol Krasniqi, Kryetar i Këshillit me 206 vota
2. Xhavit Shala, Nenkryetar me 162 vota
3. Kadri Tafili, anëtar i Kryesisë
4. Nikollë Berisha, anëtar i Kryesisë
5. Sejdi Desku, anëtar i Kryesisë

Antaret e Komisionit

Binak Sylaj _____

Arta Pantina _____

Luigj Ademi _____

Nrecë Zefaj _____

Zafer Gashi _____

Vitore Zefi _____

Lirim Gashi _____

Sygjerim nga antaret e komisionit, që në Zgjedhjet e bashksive tjera të caktohet ora e fillimit dhe mbylljes së vendvotimit.

Procesmbajtës: Vitore Zefi-OJQ

